

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686,
DATË 29.07.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE
PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT
NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË
VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE”, TË NDRYSHUAR”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektvendimit është që të lehtësojë personat fizik ose juridik nga procedurat administrative lidhur me përshpejtimin e afateve kohore të procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM). Gjithashtu synon harmonizimin e tij me parashikimet në Kodin e Procedurës Administrative në kuadër të përmirësimit të procedurës për shqyrtimin e kërkesave për vlerësimin e ndikimit në mjedis të çdo zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt që është subjekt i ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, duke i lënë hapësirë që në rast parregullësish, të plotësojë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërhyrjet janë në të njëjtën linjë me reformën e riinxhinierimit dhe derregullimit, që parashikojnë ofrimin e shërbimit për qytetarët dhe subjektet e tjera, me qëllim evidentimin e ndërhyrjeve përkatëse në funksion të eliminimit/reduktimit/thjeshtëzimit të dokumenteve (procedurave) që kërkohen për përfitim të shërbimit të caktuar, i lidhur ky proces edhe me punën që po bëjmë me përqasjen e legjislacionit me Kodin e Procedurave Administrative. Duke qënë se pajisja me vendimin e VNM-së paraprake dhe VNM-në e thelluar bëhet tashmë nëpërmjet aplikimit elektronik, risia e këtij projektvendimi është qartësimi i procedurës së aplikimit, fillimit të shqyrtimit administrativ dhe reduktimi i afateve të trajtimit të kërkesës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për vitin 2023, por vjen në zbatim të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe është në përputhje me Reformën e Derregullimit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e propozuara lehtësojnë ndjeshëm, si në procedurë dhe në kohë, subjektet pas unifikimit me Kodin e Proçedurave Administrative ku parashikohet të amendohen ato pika, të cilat trajtojnë afatet për plotësim dokumentacioni dhe reduktimin e tyre gjatë shqyrtimit të aplikimeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-në). Unifikimi i neneve të këtij vendimi me Kodin e Proçedurave Administrative bën të mundur realizimin efektiv dhe në kohë të funksioneve publike administrative të institucioneve përgjegjëse, në shërbim të zhvilluesit që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar. Gjithashtu, me rishikimin e vendimit bazë, është bërë edhe një rivlerësim i dokumentacionit shoqëruar që zhvilluesi dorëzon së bashku me kërkesën e aplikimit në sistemin elektronik, duke synuar reduktimin e dokumentacionit të panevojshëm apo atë dokumentacion që institucioni mund ta sigurojë vetë nëpërmjet platformave elektronike. Aktualisht, zhvilluesi ngarkon në sistem 18 dokumenta për tu pajisur me vendimin për VNM-në paraprake dhe 17 dokumenta për Deklaratën Mjedisore. Me rishikimin që do të bëhet sistemit elektronik pas miratimit të projektvendimit numri i dokumentave do të reduktohet ndjeshëm si për vendimin e VNM-së paraprake dhe për deklaratën mjedisore.

Përsa më sipër, ndërhyrjet janë në harmonizim me reformën e derregullimit, e cila synon të lehtësojë proçedurat dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike, duke thjeshtëzuar proçedurat, duke eliminuar dokumentet, lejet, licencat apo autorizimet e panevojshme që institucionet shtetërore kërkojnë në këmbim të ofrimit të shërbimeve, pa cenuar mbrojtjen e mjedisit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMERISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ndryshimet e propozuara në projektakt nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PERMBLEDHJE SHPJEGUESE E PERMBAJTJES SE PROJEKTAKTIT.

Për të lehtësuar kuptimin e këtij projektvendimi sqarojmë se parimet e procedurës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe projektet që janë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) janë përcaktuar e miratuar në ligjin 10440, datë 07. 07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar. Ky projektvendim synon harmonizimin me Kodin e Proedurave Administrative, në procesin e plotësimit të dokumentacionit si dhe reduktimin e afateve të parashikuara në vendim, duke sjellë rrjedhimisht një proces më të shpejtë dhe efikas për zhvilluesin, i cili aplikon për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM).

Konkretisht në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pjesën e parë të projektvendimit është parashikuar që kudo në përmbajtje të vendimit fjala “kalendarike” zëvendësohet me fjalën “pune”.

Në pjesën e dytë të projektvendimit janë parashikuar disa shtesa dhe ndryshime në kreun I të vendimit. Përkatësisht, pika 1 parashikon ndryshime në pikën 1.1 të vendimit: shkronja “a” parashikon riformulimin e shkronjës “i” duke detajuar informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, ndërkohë që shkronja “b” parashikon ndryshimin e shkronjës “j” duke i hequr kopjet e tyre dhe zëvendësuar ato, me informacionin për marrdhënien me tokën ku do të zhvillohet projekti, në funksion të eliminimit dhe

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar.

thjeshtëzimit të dokumenteve që kërkohen për raportin teknik të projektit, në proporcion me reformën e derregullimit.

Shkronja “c” parashikon riformulimin e paragrafit të fundit të pikës 1.2 në vendim, në funksion të përshtatjes me parashikimet e ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, sipas të cilit raporti paraprak i VNM-së duhet të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik i certifikuar nga ministri dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të VNM-së.

Gjithashtu në shkronjën “ç”, të pikës 1, parashikohet shtimi i pikës 1.5 në vendim, në përmbajtje të së cilës është shtuar dhe prokura kur aplikimi nuk bëhet nga zhvilluesi, por subjekte të tjera të autorizuara nga zhvilluesi.

Pika 2 e projektvendimit parashikon ndryshimin e pikës 3 të vendimit, duke riformuluar fazën paraprake të veprimeve që do të kryejë Ministria, e cila pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, ia përcjell menjëherë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

Në pikën 3 është parashikuar riformulimi i pikës 4 të vendimit, në kuadër të reduktimit të afateve, konkretisht nga 10 (dhjetë) ditë pune, në 7 (shtatë) ditë pune, për shqyrtimin e kërkesës nga AKM si dhe nga 45 (dyzet e pesë) ditë pune, në 30 (tridhjetë) ditë pune, për plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara.

Në pikën 4 të projektvendimit është parashikuar shtimi i pikës 4/1 në vendim, në kuadër të harmonizimit me Kodin e Proçedurave Administrative, duke parashikuar dispozitën për mosplotësimin e dokumentacionit nga ana e zhvilluesit brenda afatit të përcaktuar në vendim. Kërkesa në këtë rast quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet zhvilluesit bashkë me aktet e tjera.

Në vijim të pikës 4/1, është shtuar gjithashtu pika 4/2, në kuadër të harmonizimit me Kodin e Proçedurave Administrative, e cila parashikon shtimin e Drejtorive Teknike të Ministrisë, në listën e institucioneve që Agjencia Kombëtare e Mjedisit ia dërgon për mendim si dhe reduktimin e afatit nga 10 (dhjetë) ditë pune, në 7 (shtatë) ditë pune, për dhënie mendimi nga këto institucione të parashikuara në VKM nr. 686/2015.

Pika 5 parashikon ndryshimin e pikës 5 të vendimit, duke sjellë reduktim të afateve kohore nga 3 (tre) ditë pune, në 2 (dy) ditë pune për Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) për të përcjellë aplikimin për mendim te njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat shprehen brenda 3 (tre) ditë pune, nga 6 (gjashtë) ditë pune, që ishte parashikuar.

Në pikën 6 parashikohet riformulimi i pikës 7 të vendimit, në funksion të qartësimin të proçedurës që do të ndjekë AKM, në momentin kur institucionet

nuk shprehen brenda afatit të përcaktuar në vendim, e cila në këtë rast do të vijojë me procedurën e shqyrtimit të kërkesës dhe vendimmarrjen brenda 22 (njëzet e dy) ditë pune, nga 30 (tridhjetë) ditë pune, që ishte parashikuar.

Pika 7 parashikon shfuqizimin e pikës 11 të vendimit, për shkak se përmbajtja e kësaj dispozite është parashikuar në pikën 7 të vendimit, duke ia lënë AKM-së kompetencën për përcjelljen e vendimit të zhvilluesi.

Pika 8 parashikon që në pikën 12 të vendimit, afati maksimal për dërgimin e vendimit të zhvilluesi të reduktohet nga 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, në 24 (njëzet e katër) ditë pune.

Në pjesën e tretë të projektvendimit janë parashikuar disa shtesa dhe ndryshime në kreun II të vendimit. Përkatësisht pika 1 parashikon ndryshime në pikën 1.1 të vendimit: shkronja “a” parashikon riformulimin e shkronjës “i” duke detajuar informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, ndërkohë që shkronja “b” parashikon ndryshimin e shkronjës “j” duke i hequr kopjet e tyre dhe zëvendësuar ato, me informacionin për marrdhënien me tokën ku do të zhvillohet projekti, në funksion të eliminimit dhe thjeshtëzimit të dokumenteve që kërkohen për raportin teknik të projektit, në proporcion me reformën e derregullimit.

Shkronja “c” parashikon riformulimin e fjalisë hyrëse të pikës 1.2 në vendim, në funksion të përshtatjes me parashikimet e ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, sipas të cilit informacioni për ndërveprimin me mjedisin të projektit të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik i çertifikuar nga ministri dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të VNM-së.

Gjithashtu në shkronjën “ç”, të pikës 1 të projektvendimit, parashikohet shtimi i pikës 1.3 në vendim, në përmbajtje të së cilës është shtuar dhe prokura kur aplikimi nuk bëhet nga zhvilluesi, por subjekte të tjera të autorizuar nga zhvilluesi.

Pika 2 parashikon ndryshimin e pikës 3 të vendimit, duke riformuluar fazën paraprake të veprimeve që do të kryejë Ministria, e cila pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, ia përcjell menjëherë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

Në pikën 3 është parashikuar riformulimi i pikës 4 të vendimit, në kuadër të reduktimit të afateve, konkretisht nga 10 (dhjetë) ditë pune, në 7 (shtatë) ditë pune, për shqyrtimin e kërkesës nga AKM si dhe nga 45 (dyzet e pesë) ditë pune, në 30 (tridhjetë) ditë pune, për plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara.

Në pikën 4 të projektvendimit është parashikuar shtimi i pikës 4/1 në vendim, në kuadër të harmonizimit me Kodin e Proçedurave Administrative, duke parashikuar dispozitën për mosplotësimin e dokumentacionit nga ana e zhvilluesit brenda afatit të përcaktuar në vendim. Kërkesa në këtë rast quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet zhvilluesit bashkë me aktet e tjera.

Në vijim të pikës 4/1, është shtuar gjithashtu pika 4/2, në kuadër të harmonizimit me Kodin e Proçedurave Administrative, e cila parashikon shtimin e Drejtorive Teknike të Ministrisë, në listën e institucioneve që Agjencia Kombëtare e Mjedisit ia dërgon për mendim si dhe reduktimin e afatit nga 10 (dhjetë) ditë pune në 7 (shtatë) ditë pune, për dhënie mendimi nga këto institucione të parashikuara në VKM nr.686/2015.

Pika 5 parashikon ndryshimin e pikës 5 të vendimit, duke sjellë reduktim të afateve kohore nga 3 (tre) ditë pune në 2 (dy) ditë pune për Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), për ta përcjellë aplikimin për mendim te njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat shprehen brenda 3 (tre) ditë pune, nga 6 (gjashtë) ditë pune që ishte parashikuar.

Në pikën 6 parashikohet që në pikën 7 të vendimit afati maksimal për dërgimin e vendimit të zhvilluesi të reduktohet nga 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike në 25 (njëzet e pesë) ditë pune.

Pika 7 parashikon që shkronja "a" e pikës 10 të riformulohet, në funksion të përshtatjes me ndryshimet e mësipërme të VKM nr. 686/2015. Ndërkohë që shkronja "b", parashikon që pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e", në përmbajtje të së cilës është shtuar dhe prokura kur aplikimi nuk bëhet nga zhvilluesi, por subjekte të tjera të autorizuara nga zhvilluesi.

Pika 8 parashikon riformulimin e pikës 11 të vendimit, në funksion të reduktimit të afatit nga 10 (dhjetë) ditë pune në 3 (tre) ditë pune për përcjelljen e aplikimit nga Ministria në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në fazën e kërkesës për t'u pajisur me deklaratë mjedisore.

Në pjesën e katërt të projektvendimit parashikohen ndryshime në kreun III të vendimit, konkretisht: Në pikën 1 parashikohet që togfjalëshi "brenda 15 (pesëmbëshjetë) ditëve kalendarike" zëvendësohet me togfjalëshin "brenda 10 (dhjetë) ditëve pune", në pikat 2 dhe 4 të vendimit, në kuadër të reduktimit të afatit të transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore që përcillet te zhvilluesi. Ndërsa në pikën 2 parashikohet riformulimi i shkronjës "c" të pikës

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar.

3, duke qartësuar përmbajtjen e raportit mbi zbatimin e kushteve të deklaratës mjedisore.

Në pjesën e pestë të projektvendimit parashikohet dispozita kalimtare për rregullimin në VKM-në nr. 686/2015, të kërkesave të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të vendimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PER ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. MINISTRITE, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QE KANE KONTRIBUAR NE HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore dhe Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor, Lejeve dhe Licensave.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Brendshme, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

IX. RAPORTI I VLERESIMIT TE TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar.